



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1224/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Naim Raçi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së në Podujevë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Naim Raçi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Podujevë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:35 nga Naim Raçi kandidat për anëtar të kuvendit komunal, duke pretenduar sipas KKZ-ve nga vendvotimi ka pasur 218 vota pa disa vendvotim SH.M.E "Isa Boletin" si dhe në fshatrat Lladovc, Pakashtic dhe Lapashtic e Poshtme, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së, Naim Raçi, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindse me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1224/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.